

TË ZHVILLOSH BISEDË TË QËLLIMSHME UNGJILLËZUESE

Nga TODD MORR



WWW.MISSIONALMADESIMPLE.COM

TË ZHVILLOSH BISEDA TË QËLLIMSHME UNGJILLËZUESE

Koha e kaluar me jo të krishterët, edhe pse është një mënyrë e çmuar për t'i dashur dhe bekuar, nuk është thelbi i të qenët misionar dhe as e shpreh plotësisht thirrjen për ta jetuar jetën si dishepuj të Jezusit. Një pjesë e identitetit të krishterë është edhe të jesh dëshmitar, ambasador dhe të shpallësh Jezusin.

A është kjo një punë vetëm për ungjillorët socialë apo të krishterët e trajnuar? Jo, kjo i takon çdo të krishteri.

A duhet bërë kjo vetëm në disa raste, apo vetëm në raste dhe vende të veçanta? Jo, duhet bërë shpesh, në mënyra të ndryshme, gjatë ndërveprimeve të përditshme, në punë, shkollë, lagje, në palestër, në aktivitetet sportive dhe ato jashtëshkollore të fëmijëve tanë, etj.

Pra, si mund të mësojmë ta bëjmë këtë dhe t'i ndihmojmë anëtarët e kishës të zhvillojnë biseda të qëllimshme ungjillëzuese në një festë, gjatë pushimit të drekës, gjatë vakteve, në park, në një event sportiv apo në një koncert me miqtë? Po ju sugjeroj disa parime të thjeshta, sikurse edhe një proces po aq të thjeshtë për të cilin besoj se Zoti na ka pajisur të gjithëve me aftësinë për të qenë frytdhënës dhe të dobishëm.

Përgjatë kohës, këto parime plotësojnë dhe ndihmojnë njëra-tjetrën për t'i shndërruar marrëdhëniet tona me jo të krishterët në miqësi të ngushta. Me kalimin e kohës, ato ndikojnë te njëra-tjetra në mënyrë që ta njohim më mirë historinë e dikujt, për ta njohur më mirë historinë e Perëndisë, dhe si përfundim për të qartësuar dhe komunikuar idenë se Jezusi është përgjigjja e nevojave thelbësore në jetën e çdo individi.

Kujto që ky proces zhvillohet përgjatë kohës. Për disa njerëz, ky progres mund të jetë i ngadaltë, ndërsa për disa të tjerë mund të jetë i shpejtë. E rëndësishme është që po investojmë vazhdimisht në jetët e njerëzve, duke u treguar të qëllimshëm ndërsa kalojmë kohë dhe zhvillojmë biseda me ta.

SHËRBE/BEKO

Ndërsa i forcojmë marrëdhëniet me të tjerët, qofshin ata të njohur apo fqinj prej një kohe të gjatë, jemi duke kërkuar mënyra konkrete për t'u shërbyer dhe për t'i bekuar. Kjo mund të përfshijë një sërë mënyrash, duke nisur nga gjërat më të vogla te më të mëdhatë. T'i sjellësh kolegut/es kafënë apo ushqimin e parapëlqyer. Të qerasësh një koleg/e apo fqinj me mëngjesin apo drekën. Të ndihmosh me një projekt shtëpie, ta bekosh me një dhuratë për ditëlindje, përvjetor apo Krishtlindje, të kujdesesh për fëmijët e një çifti në mënyrë që ata të dalin në mbrëmje, etj. Ndërsa shërbejmë dhe bekojmë vazhdimisht kështu, krijojmë besim dhe mundësi për të zhvilluar biseda cilësore.

HISTORIA E TYRE

Qoftë 5 minuta para se të nisemi për punë, 10 minuta në lagje, gjysmë ore në drekë, 20 minuta pas stërvitjes ose palestrës, apo 90 minuta gjatë ndeshjes së fëmijëve, ne e kemi gjithmonë



mundësinë t'i thellojmë marrëdhëniet me ta. Për ta bërë këtë duhet t'i duam të tjerët aq sa të motivohemi për t'i dëgjuar vazhdimisht historitë e tyre.

Këtë e arrijmë duke bërë ShUMË pyetje të singerta dhe duke qenë dëgjues të mirë. Ndërsa u bëjmë njerëzve pyetje të mira dhe i dëgjojmë me vëmendje, do të kuptojmë si mund t'u shërbejmë konkretisht, çfarë pyetjeje tjetër mund të bëjmë për t'u thelluar në historinë e tyre dhe kështu do të fillojmë të dëgjojmë cilat janë arsyet, që i mbajnë ata larg kishës dhe Perëndisë.

HISTORIA JONË

Ndërsa zhvillojmë biseda me të tjerët dhe u bëjmë pyetje të mira duke u treguar dëgjues të vëmendshëm, do të ketë gjithmonë aspekte të historisë së tyre, të cilat lidhen me historinë tonë. Këto aspekte do të jenë ose të ngjashme me historinë tonë ose të kundërta. Ata janë rritur në një qytet të madh. Ne jemi rritur në një qytet të madh ose të vogël. Ata vijnë nga një familje e vogël. Ne vijmë nga një familje e vogël ose e madhe. Atyre u pëlqen të luajnë sporte të ndryshme. Neve na pëlqen të luajmë sporte të ndryshme ose jo, por kemi hobi të tjera.

Do të ketë gjithmonë ngjashmëri ose dallime, çka do të thotë se do të kemi GJITHMONË mundësi të flasim për historinë tonë duke bërë lidhje me historinë e tyre. Kur ndodh kjo, krijohet besim tek ne dhe i lejon ata të na njohin, ashtu siç na lejon ne t'i njohim ata. Kujto, kjo ndodh me kalimin e kohës dhe duke zhvilluar shumë biseda. 10 minuta në punë sot, 30 minuta pas pune javën tjetër, një orë duke konsumuar një vakt para ndeshjes së futbollit të dielën pas një jave, 30 minuta gjatë drekës pas dy javësh. Duke bërë gjithmonë e më shumë pyetje. Duke u thelluar gjithmonë e më tepër në historinë e tyre. Duke treguar përherë e më tepër historinë tonë.

HISTORIA E PERËNDISË

Ndërsa thellohemi në historinë e dikujt dhe tregojmë historinë tonë, do të ketë gjithmonë mundësi për të pyetur në mënyrë të natyrshme rreth botës shpirtërore ose për të bërë lidhje të botës shpirtërore me historinë tonë. Ndoshta mund të pyesim ose të bisedojmë rreth përfshirjes sonë në kishë. Mund të flasim rreth gjërave, që kisha jonë ose Komuniteti Misional bën për të bekuar qytetin, lagjen, për të ndihmuar nënat e vetme, për të përmbushur nevojat e familjeve të varfra, për përkujdesin ndaj fqinjëve në gjendje jo të mirë shëndetësore, etj.

Mund t'i pyesim nëse mund të lutemi për ta apo edhe të flasim për rolin e lutjes në jetët tona, familjet tona apo për detaje praktike rreth jetës sonë. Mund të krijojmë një urë komunikimi për tema si; qasja jonë ndaj punës, martesës, prindërimit, të ardhurave, pensionit, pushimeve, etj. Kur të ndodhë kjo, do të ndodhë në një kontekst marrëdhëniesh të ngushta dhe të besueshme miqësore, ku dashuria është shfaqur qartë dhe me zemërgjerësi.

HEROI JEZUS

Ndërsa marrëdhëniet forcohen dhe thellohen sipas mënyrave të përshkruara më lart, ato do të drejtohen rreth mundësive për biseda shpirtërore, të zhvilluara me dashuri të vazhdueshme dhe qëllimshmëri. Duke vazhduar kështu, do të krijohen mundësi të tjera për të folur hapur për Jezusin, heroin e historisë së Perëndisë. Do të shfaqen mundësi të reja për të folur rreth mënyrës se si e ka ndryshuar Jezusi jetën tënde, për arsyet pse kishe nevojë për Jezusin që jeta jote të ndryshonte dhe se si mund t'i ndryshojë ai edhe jetët e tyre. Si është Ai përgjigjja e problemeve në



historinë e tyre, si është Ai e vetmja zgjidhje për të rivendosur marrëdhënien me Perëndinë dhe si është Ai i vetmi që mund të sigurojë jetën me bollëk, të cilën Perëndia e kishte në plan për çdo person.

PYETJE TË MIRA

Në këtë pikë, ti mund të jesh duke pyetur, "Cilat janë ato pyetje të mira, të sigerta, që mund t'ua bëj njerëzve në mënyrë që të njoh historinë e tyre?" A mund të më japësh disa shembuj? Më poshtë do të gjesh disa prej tyre dhe jam i sigurt që mund të mendosh për shumë pyetje të tjera të ngjashme me to.

- A mund të më tregosh për familjen tënde? Ku je rritur? Si je rritur? (qytet, rrethina, fshat, klasa e mesme, të ardhura të ulëta, etj.)
- Duke u rritur, si ka qenë marrëdhënia jote me prindërit? Po me motrat dhe vëllezërit? Me miqtë? Po me mësuesit dhe trajnerët?
- Cilët kanë qenë disa nga njerëzit më me ndikim në jetën tënde? Pse?
- Si e kaloje kohën duke u rritur? Cilat janë disa nga gjërat që të pëlqen të bësh? Cilat janë vendet, ku të pëlqen të shkosh?
- Cilat janë disa nga kujtimet e tua më të mira nga fillorja, 9-vjeçarja ose e shkolla e mesme?
- Si ka qenë përvoja jote në universitet? Cilat ishin anët pozitive dhe cilat negative?
- Cilat mendon se kanë qenë disa nga përvojat, që kanë ndikuar në formimin tënd?
- Cilat kanë qenë punët e tua më të mira, po ato më të këqijat?
- Si do të doje t'i kaloje ditët e pushimit, po fundjavat, po pushimet vjetore?
- Cilat janë vendet më të bukura që ke vizituar? Pse?
- Të pëlqen të lexosh? Çfarë librash parapëlqen të lexosh? Çfarë filmash apo programesh televizive të pëlqen të shikosh? Çfarë muzike dëgjon?
- Si e mban trupin në formë dhe të shëndetshëm?

Zakonisht, pavarësisht përgjigjes së tyre, mund ta vazhdosh bisedën duke pyetur "pse" apo mund t'u kërkesh të të tregojnë më tepër për temën për të cilën po bisedoni. "A mund të më tregosh më tepër për këtë?" ose "Do të doja të dëgjoja më tepër për këtë." Këto pyetje nxitëse janë ndihmuese për të krijuar një lidhje të fortë miqësie dhe për të kuptuar më mirë historinë e tyre.

SI E SHPALLIM JEZUSIN?

Në pamjen e mëposhtme do të shohësh shigjeta të drejtuara në formën e një rrethi. Kjo tregon se bisedat tona dhe marrëdhëniet me të tjerët janë në një proces zhvillimi. Ato ndodhin përgjatë kohës, zhvillohen dhe thellohen me kalimin e kohës. Marrëdhëniet tona me të tjerët krijohen nga shumë, shumë biseda... Ndonjëherë krijohen në një kohë të shkurtër dhe herë të tjera në një kohë të gjatë. Ndërsa thellohem, krijojmë besim dhe ndërtojmë marrëdhënie, do të zhvillohen biseda të rëndësishme shpirtërore për jetën e tyre dhe tonat.

Kjo është përshkruar vizualisht në qendër të rrethit. Përmes bekimeve të vazhdueshme dhe përpjekjes për të dëgjuar historitë e tyre, marrëdhëniet tona do të kalojnë përmes këtij procesi: thjesht duke u takuar me ta; më pas duke u bërë të njohur; duke ndërtuar miqësi të ngushta dhe në fund me shpresën, që ata do të bëhen dishepuj dhe miq të Jezusit.



